



MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE
KUALIFIKIMEVE
DREJTORIA E ZVILLIMIT TË PROGRAMEVE DHE OFRUESVE TË AFP

PROGRAM KUALIFIKIMI

**“PËR MËSIMDHËNËSIT E PRAKTIKËS PROFESIONALE, TË EMËRUAR SI
MËSIMDHËNËS ME KOHË TË PLOTË DHE ZOTËROJNË NJË SHKOLLIM TË
MESËM PROFESIONAL, PAS TË MESËM PROFESIONAL OSE DIPLOMË TË
NIVELIT BACHELOR, NË FUSHAT PROFESIONALE PËRKATËSE”**

(Grupi B sipas përcaktimit në Udhëzimin nr.21 të MFE, datë 27.6.2022, i ndryshuar)

Tiranë, 2025

TABELA E PËRMBAJTJES

1.	Informacion i përgjithshëm.....	3
2.	Qëllimi i programit të kualifikimit.....	3
3.	Përmbajtja e programit të kualifikimit.....	4
	FUSHA: DOKUMENTE ZYRTARE TË PËRGJITHSHME DHE SPECIFIKE PËR AFP-në.....	5
	FUSHA: ASPEKTE TË METODOLOGJISË DHE PËRDORIMIT TË TIK-ut NË PROCESIN MËSIMOR NË AFP	7
	FUSHA: VLERËSIMI I TË NXËNIT NË AFP.....	14
	FUSHA: KRIJIMI I ATMOSFERËS POZITIVE NË PROCESIN MËSIMOR.....	20
	FUSHA: MJEDISI DHE MËSIMI DIGJITAL NË AFP	25
	FUSHA: ZHVILLIMI PROFESIONAL NË PROFESIONIN PËRKATËS.....	31
	FUSHA: ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE	34
4.	Model pyetjesh të provimit të kualifikimit për kategorinë “Mësues i kualifikuar” dhe “Mësues specialist”	36
5.	Model i një seance mësimore të hapur për të fituar kategorinë “Mësues mjeshtër”	42
	Model 1 - Seancë mësimore praktike.....	42
	Model 2 - Seancë mësimore teorike.....	45

1. Informacion i përgjithshëm

Programi i kualifikimit profesional për mësimdhënësit e praktikës profesionale, të emëruar si mësimdhënës me kohë të plotë dhe zotërojnë një shkollim të mesëm profesional, pas të mesëm profesional ose diplomë të nivelit Bachelor, në fushat profesionale përkatëse (Grupi B), është hartuar nga grupi i punës, i ngritur nga Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK) për t'u ardhur në ndihmë të gjithë mësimdhënësve të kulturës profesionale teorike dhe/ose praktike në AFP-së, për të plotësuar kërkesat për marrjen e tri shkallëve të kualifikimit:

- Mësues i kualifikuar.
- Mësues specialist.
- Mësues mjeshtr.

Programi është zhvilluar duke iu përgjigjur kërkesave që Ministria e Financës dhe Ekonomisë (MFE) ka vendosur në Udhëzimin Nr.21 dt. 27.6.2022 “Për kualifikimin e vazhduar profesional të mësimdhënësve të kulturës profesionale në AFP”, i ndryshuar, për mësimdhënësit e kulturës profesionale me kohë të plotë dhe zotërojnë një shkollim të mesëm profesional, pas të mesëm profesional ose diplomë të nivelit Bachelor, në fushat profesionale përkatëse, që kualifikohen. Programi është hartuar duke mbajtur parasysh fushat kryesore në të cilat testohen njohuritë dhe aftësitë e mësimdhënësve të kulturës profesionale, të mëposhtme:

- Dokumente zyrtare¹, të cilat kanë të bëjnë me veprimtarinë mësimore - zhvillimore të mësimdhënësve të kulturës profesionale në AFP.
- Dokumentacioni në nivel shkolle.
- Aspekte të pedagogjisë, andragogjisë dhe të metodologjisë në mësimdhënie dhe të nxënies në arsimin dhe formimin profesional.
- Aspekte të etikës dhe të komunikimit.
- Aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe.

2. Qëllimi i programit të kualifikimit

Programi i kualifikimit të vazhduar profesional për mësimdhënësit e praktikës profesionale, të emëruar si mësimdhënës me kohë të plotë dhe që zotërojnë një shkollim të mesëm profesional, pas të mesëm profesional ose diplomë të nivelit Bachelor, në fushat profesionale përkatëse, është hartuar dhe rishikuar për të mbështetur dhe për të nxitur zhvillimin profesional të tyre. Programi është rishikuar nga grupi i punës, bazuar në përvojën dhe praktikën e mëparshme të zbatuar për kualifikimin e vazhduar të mësuesve të AP nga AKAFPK, si dhe duke mbajtur parasysh përmbushjen e tre qëllimeve kryesore:

1. Të ofrohet si një program orientues për t'u ardhur në ndihmë ofruesve të AFP-së, si dhe të gjithë mësimdhënësve të kulturës profesionale për të realizuar veprimtaritë kualifikuese dhe trajnuese, në kuadrin e zhvillimit të vazhduar profesional.
2. Të ofrohet si një program i detyruar veçanërisht për mësimdhënësit që atë vit do të marrin shkallët e kualifikimit, në mënyrë që ata të realizojnë një përgatitje gjithëvjetoje, për të përballuar me sukses kërkesat e provimit të kualifikimit që bëhet për mësuesit e arsimit profesional për marrjen e shkallëve të kualifikimit.
3. Të orientojë ofruesit e kurseve të akredituara të trajnimit për mësimdhënësit e AFP që të përgatisin programe në përputhje me kërkesat dhe nevojat reale për kualifikimin dhe zhvillimin e vazhduar profesional të mësimdhënësve të kësaj kategorie.

Programi synon rritjen e përgjegjshmërisë dhe aftësive të mësimdhënësve të kulturës profesionale për:

¹ Është fjala për të gjitha dokumentet ligjore, urdhëresat dhe udhëzimet e MFE që zbatohen në shkollë duke u përqendruar në ato të viteve të fundit.

njohjen dhe zbatimin e legjislacionit arsimor e në mënyrë të veçantë të risive më të fundit të reformës së AFP-së;

rritjen e aftësive dhe kompetencave profesionale të mësimdhënësve për një mësimdhënie të suksesshme dhe cilësore;

domosdoshmërinë e zbatimit të koncepteve dhe ligjësive shkencore të lëndëve/moduleve në praktikë, në përputhje me specifikat e kualifikimit profesional, moshës së nxënësve dhe të kursantëve, ku japin mësim;

njohjen dhe zbatimin e rregullave të etikës dhe komunikimit në punën e tyre në institucionin ofrues të AFP-së;

zbatimin me saktësi të rregullave drejtshkimore të shqipes;

realizimin në praktikë nëpërmjet demonstrimit konkret të aftësive të fituara, e në mënyrë të veçantë nëpërmjet vlerësimit të arritjeve përmes testimit dhe vëzhgimit.

3. Përmbajtja e programit të kualifikimit

Programi i kualifikimit për mësimdhënësit e praktikës profesionale, të emëruar si mësimdhënës me kohë të plotë dhe zotërojnë një shkollim të mesëm profesional, pas të mesëm profesional ose diplomë të nivelit Bachelor, në fushat profesionale përkatëse është strukturuar sipas fushave kryesore të zhvillimit profesional të përmendura më sipër, për të cilat kualifikohen mësimdhënësit. Për secilën fushë janë renditur njohuritë dhe aftësitë bazë që duhet të zotërojnë mësimdhënësi i kulturës profesionale teorike dhe/ose praktike me kohë të plotë në AFP që të përmbushë me sukses edhe kërkesat e provimit të kualifikimit.

Programi është ndërtuar edhe duke pasur si pikënisje standardet e mësimdhënësit të kulturës profesionale. Përshkallëzimi i kompetencave profesionale që lidhen me secilën fushë të kualifikimit do ta ndihmojnë mësimdhënësin e kulturës profesionale që të identifikojë nevojat e tij/saj, si dhe çështjet në të cilat duhet të thellohet më shumë.

FUSHA: DOKUMENTE ZYRTARE TË PËRGJITHSHME DHE SPECIFIKE PËR AFP-në

Kompetenca I: “Zbatimi me përgjegjshmëri i kërkesave të legjislacionit dhe dokumentacionit shkollor”	Literatura e rekomanduar
Mësimdhënësi i kulturës profesionale teorike dhe/ose praktike në AFP duhet të jetë i aftë: • të njohë ligjin për arsimin parauniversitar, duke interpretuar referencat në lidhje me arsimin profesional; • të interpretojë ligjin për AFP-në, ndryshimet dhe shtesat përkatëse; • të interpretojnë aktet nënligjore që rregullojnë organizimin, funksionimin dhe sjelljen e AFP-së; • të interpretojë paketën ligjore mbi të cilën funksionon sistemi i arsimit në formë të dyfishtë (dual); • të njohë si lidhen referencat me mësimdhënësit sipas Kodit të Punës, të drejtat dhe detyrimet në lidhje me punësimin; • të dallojë elementet kyç të Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023–2030; • të kuptojë lidhjet midis arsimit profesional, punësimit dhe zhvillimit të aftësive; • të kuptojë veçoritë e strukturës së arsimit profesional; • të njohë strukturën institucionale dhe organizative të AFP; • të përshkruajë statusin e mësimdhënësit të AFP-së, funksionet, të drejtat dhe detyrat e tij; • të përshkruajë metodat e parimeve, udhëzimet dhe rekomandimet që përmbahen në dokumentet bazë të AFP-së; • të zbatojë rregullat e dokumenteve zyrtare në praktikat, rekomandimet dhe formulimet e përditshme;	– Ligji “Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë”, Nr. 15/2017, datë 16.02.2017, i ndryshuar. – Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. – Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë , në aspektet që lidhen me të drejtat dhe detyrimet e mësimdhënëseve dhe ndryshimet me punëdhënësin. – Udhëzim i MEKI, nr. 759, datë 30.9.2024 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit” – Vendim Nr.691, datë 6.11.2024 “Për përcaktimin e rregullave të veçanta që zbatohen për kontratën e mësimi të profesionit dhe përcaktimin e pagës minimale për mësimin e profesionit në arsimin dhe formimin profesional në formën e dyfishtë”. – Urdhër nr 220, datë 16.09.2020 për miratimin e rregullores “Për zbatimin e praktikave profesionale ne biznes ne kuadër të ndjekjes se programeve të AFP-së në institucionet publike te arsimit dhe formimit profesional”. – Udhëzim Nr.1090, datë 12.12.2024 “Për procedurat e planifikimit dhe zbatimin e arsimit dhe formimit profesional në formën e

• të zbatojë dokumentet zyrtare në lidhje me partneritetin me bizneset, praktikat profesionale dhe mësimin në punë (Work-Based Learning); • të interpretojë dhe përdorë dokumentet administrative në gjuhën e AFP-së; • të përdorë dokumentacionin që lidhet me procesin mësimor, që përfshin: skeletkurrikulat e AFP-së, programet e kurseve të unifikuara, kurrikulat në nivelin e ofruesit, planet e mësimdhënies teorike dhe praktike, programet e praktikave profesionale në biznes, ditarin e mësimin, instrumente të vlerësimit, evidencat dhe regjistrat elektronikë, certifikatat dhe dokumentacionin shoqërues; • të respektojë procedurat e brendshme dhe standardet institucionale.	dyfishtë”. – Udhëzimi Nr.14 dt 10.7.2023 "Për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore të punonjësve arsimore”. – Udhëzimi Nr.15 datë 26.04.2019, Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve në AFP. – Udhëzimi Nr. 1090, datë 12.12.2024 "Për procedurat e planifikimit dhe zbatimin e arsimit dhe formimit profesional në formën e dyfishtë" – Udhëzimet e përvitshme “Për zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore”. – Udhëzimi Nr.21, datë 27.6.2022 “Për kualifikimin e vazhduar profesional të mësimdhënësve të kulturës profesionale në AFP”, i ndryshuar. – Udhëzim Nr. 16, datë 8.5.2018 “Për zhvillimin e vetëvlerësimit në institucionet ofruese të arsimit dhe formimit profesional”. – Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2023–2030 – Standardet e profesionit “Mësimdhënës i kulturës profesionale në AFP”, i ndryshuar. – Skeletkurrikulat e AFP-së, të publikuara nga AKAFPK. – Udhëzues i përvitshëm për shkollat profesionale publike në kuadrin e fillimit të vitit të ri shkollor. – Udhëzuesit metodologjikë për hartimin e kurrikulave në AFP. – Manuali “Bazat e didaktikës në AFP”, i rishikuar. – Broshurat “Arsimi dhe Formimi Profesional”, nr. 1–12 , AKAFPK. – Plani afatmesëm, plani vjetor i shkolles, planet vjetore mësimore, ditari, kontratat e mësimin të profesionit në biznese. – Dokumentacioni (regjistrat elektronikë, rubrikat, instrumentet,
--	---

	evidencat). – Procedurat e brendshme për shërbimet profesionale të stafit dhe bashkëpunimit në me partnerët socialë. Dokumentacioni orientues evropian – Korniza Shqiptare e Kualifikimeve (KSHK) referencuar me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve (KEK). – EQAVET, Korniza Evropiane e Sigurimit të Cilësisë për AAP-në – CEDEFOP, Standardet e Arsimit dhe Trajnimit Profesional – DigCompEdu, Korniza Evropiane për Kompetencat Dixhitale të Edukatorëve. – Korniza Evropiane e Kompetencave Kryesore (2018) – Udhëzimet e Europass për Mësim, Aftësi dhe Kualifikime – Strategjia Evropiane për Aftësitë (Skills Agenda 2025–2030)
FUSHA: ASPEKTE TË METODOLOGJISË DHE PËRDORIMIT TË TIK-ut NË PROCESIN MËSIMOR NË AFP	
Kompetenca I: “Zotërimi i njohurive didaktike dhe psiko-pedagogjike/andragogjike specifike të AFP”	Literatura e rekomanduar
Mësimdhënësi i kulturës profesionale teorike dhe/ose praktike në AFP duhet të jetë i aftë: • të shpjegojë konceptet bazë të AFP-së, si: arsimi, arsimi profesional, formimi profesional, profesioni, kualifikimi profesional, pedagogjia, andragogjia, psikologjia, didaktika, metodika, objektivi mësimor profesional, metoda mësimore, stilet e të nxënësve, mediet mësimore, vlerësimi i nxënësve, instrumentet e vlerësimit, kompetencë kyçe, të nxënësve, të	– Fjalori i Arsimit dhe Formimit Profesional. – Broshurat “Arsimi dhe Formimi Profesional” , nr. 1–12, AKAFPK, www.akafpk.gov.al . – Broshura “Të mësuarit me projekte në arsimin profesional”. – Broshura “Standardet e mësimdhënies në AFP”. – Broshura “Reformimi i Kurrikulës së AFP-së”.

nxënit gjatë gjithë jetës, kurrikula, programi mësimor, lënda dhe moduli mësimor, standardet mësimore, krediti etj.; • të demonstrojë këto koncepte në lëndën, modulin ose fushën profesionale përkatëse. • të demonstrojë shembuj konkrete të koncepteve dhe termave që lidhen me aftësitë digjitale, aftësitë për zhvillim të qëndrueshëm dhe praktikën e gjelbra në fushën profesionale përkatëse; • të përshkruajë mënyra të tjera praktike të konceptit të sipërmarrjes në lëndët dhe modulet profesionale; • të integrojë aftësitë digjitale, aftësitë e qëndrueshme dhe praktikën e gjelbra në mësimdhënie; • të përshkruajë veçoritë e të mësuarit të njohurive teorike në AFP; • të përshkruajë veçoritë e të mësuarit të shprehive praktike dhe profesionale; • të përshkruajë veçoritë e stileve të nxënit dhe ndikimin e tyre në përzgjedhjen e metodave mësimore; • të përshkruajë veçoritë e perceptimit pamor dhe dëgjimor të nxënësve në mësimor; • të hartojë objektivat mësimore në përputhje me nivelin e rezultateve të të nxënit; • të përzgjedhë përmbajtjet dhe veprimtaritë mësimore; • të përzgjedhë metodat mësimore funksionale; • të përshkruajë aspekte të motivimit dhe gjithëpërfshirjes së nxënësve; • të përcaktojë instrumentet e vlerësimit; • të shpjegojë veçoritë e stileve të të nxënit; • të përshtasë mësimdhënien sipas ndryshmeve të të nxënit; • të hartojë materiale mësimore digjitale (prezantime, video, fletë pune online, udhëzime praktike);	– Udhëzues metodologjik për hartimin e kurrikulave të AFP-së në Shqipëri. – Literaturë metodat e mësimdhënies ndërvepruese dhe me mbi qendrën e nxënësve. – Udhëzues metodologjikë për mësimdhënien në AFP. – Udhëzues për hartimin e objektivave të orës, ditarin e mësuesit dhe organizimin e orëve të mësimi. – Manuali “Bazat e Didaktikës në AFP” , i rishikuar 2025. – AKAFPK. – Udhëzues për drejtuesit dhe mësuesit e shkollave profesionale (në kuadrin e fillimit të vitit shkollor në vijim). – Udhëzues metodologjik për përdorim e platformave digjitale. – Udhëzues për mësimin dual në AFP. – Manual për menaxhimin e praktikave profesionale dhe mësimi në punë. Dokumentacioni orientues evropian – DigCompEdu – Korniza Evropiane për Kompetencat Digjitale të Edukatorëve. – Korniza Evropiane e Kompetencave Digjitale (DigComp). – EQAVET – Korniza Evropiane e Sigurimit të Cilësisë në AFP. – CEDEFOP – Raporte dhe udhëzime mbi digjitalizimin në Arsimin dhe Formimin Profesional. – Strategjia Evropiane për Aftësitë Digjitale dhe Arsimin Digjital (Digital Education Action Plan 2021–2027).
---	--

• të hartojë instrumente vlerësimi digjitale, duke respektuar parimet e vlefshmërisë dhe besueshmërisë; • të përdorë platforma dhe mjete digjitale në funksion të procesit mësimor teorik dhe praktik; • të demonstrojë veçoritë e partneritetit në mësimin e dyfishtë (dual), përfshirë kontratat e mësimin të profesionit dhe të marrëveshjeve me bizneset; • të demonstrojë shembuj nga përvoja si mësimdhënës për motivimin dhe gjithëpërfshirjen e nxënësve; • të demonstrojë përshtatjen e mësimdhënies për nxënësit/kursantët me stile të ndryshme të nxënësve dhe për nxënësit me nevoja të veçanta, sipas udhëzimeve për arsimin gjithëpërfshirës; • të përshkruajë dhe demonstrojë aspekte të menaxhimit të stresit dhe konflikteve në procesin mësimor.	
Kompetenca II: “Zotërimi i parimeve bazë të të mësuarit/nxënësve (referuar specifikave të AP-së)”	Literatura e rekomanduar
Mësimdhënësi i kulturës profesionale teorike dhe/ose praktike në AFP duhet të jetë i aftë: • të rendisë parimet didaktike bazë të mësuarit/nxënësve në kontekstin e AFP-së; • të shpjegojë secilin parim didaktik bazë dhe rëndësinë e tij në mësimor teorik dhe praktik; • të dallojë specifikat e veçanta të parimeve didaktike në arsimin profesional krahasuar me arsimin e përgjithshëm; • të demonstrojë me shembuj konkret secilin parim didaktik bazë në procesin mësimor, nga lënda ose fusha profesionale përkatëse; • të aplikojë parimet bazë të të mësuarit/nxënësve duke	– AKAFPK – Udhëzues për shkollat profesionale publike (në kuadrin e fillimit të vitit shkollor në vijim). – Broshurat “Arsimi dhe Formimi Profesional”, nr. 1–12, AKAFPK. – Udhëzues metodologjik për hartimin e kurrikulave të AFP-së në Shqipëri. – Faqja zyrtare e AKAFPK-së : www.akafp.gov.al . – Manuali “Bazat e Didaktikës në AFP” , i rishikuar 2025.

përshtatur mësimdhënien me: kërkesat e tregut të punës, zhvillimin e kompetencave profesionale dhe kyçe të nxënësve, kontekstin e mësimiit teorik, praktik dhe dual. • të analizojë në mënyrë kritike dhe krijuese dokumente planifikuese mësimore (plane mësimore, programe,etj); • të vlerësojë qartësinë, koherencën dhe përshtatshmërinë e dokumenteve planifikuese me parimet didaktike të AFP-së; • të propozojë përmirësime të dokumenteve planifikuese në funksion të rritjes së efektivitetit të procesit mësimor; • të përshkruajë rëndësinë e integritit në procesin e mësimdhënies dhe të nxënies në AFP të: arsimit gjithëpërfshirës, filozofisë së të nxënësve gjatë gjithë jetës, të qëndrueshëm dhe praktikave të gjelbra, digjitalizimi dhe përdorimi i TIK-ut; • të aplikojë instrumente mësimore që nxisin barazinë, gjithëpërfshirjen, motivimin dhe aktivizimin e nxënësve/kursantëve. • të përshtasë procesin mësimor sipas niveleve, stileve të të nxënësve dhe nevojave të ndryshme të nxënësve; • të integrojë parimet e të nxënësve në kompetenca dhe rezultate të të nxënësve; • të përshtasë aftësitë profesionale, digjitale me kontekstin real të punës.	
Kompetenca III: “Përdorimi i medieve pedagogjike dhe i TIK-ut në mësimdhënie”	Literatura e rekomanduar

Mësimdhënësi i kulturës profesionale teorike dhe/ose praktike në AFP duhet të jetë i aftë: • të shpjegojë kuptimin e mjedisit mësimor, mjeteve mësimore dhe materialeve mësimore në kontekstin e AFP-së; • të klasifikojë mjetet, mjediset mësimore dhe materialet mësimore mbështetëse sipas funksionit didaktik dhe profesional; • të tregojë kushtet dhe kriteret për një mjedis mësimor të kujdesshëm, të sigurt dhe funksional, si në mësimin teorik ashtu edhe në atë praktik. • të shpjegojë kuptimin e medieve pedagogjike dhe rolin e tyre në mësimor; • të listojë dhe klasifikojë mediet pedagogjike tradicionale dhe digjitale; • të përshkruajë veçoritë e përdorimit të medieve pedagogjike në arsimin profesional, në funksion të zhvillimit të njohurive dhe shprehive praktike; • të demonstrojë shembuj konkret të përdorimit të medieve mësimore në proces mësimor, sipas lëndëve ose modulit përkatës. • të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në proceset mësimore teorike, praktike dhe të dyfishta; • të përzgjedhë dhe përdorë mjete dhe medie digjitale të përshtatshme (platforma mësimore, video, aplikacione interaktive, etj) për të mbështetur procesin e të nxënësve në AFP. • të integrojë e TIK-un në zhvillimin e kompetencave profesionale, digjitale dhe kyçe të nxënësve/kursantëve. • të përshkruajë rëndësinë e medieve në funksion të	– Udhëzues i përvitshëm i AKAFPK për shkollat profesionale publike (në kuadrin e fillimit të vitit shkollor). – Broshurat “Arsimi dhe Formimi Profesional” , nr. 1–12, AKAFPK. – Fjalori i Arsimit dhe Formimit Profesional. – Broshura “Standardet e mësimdhënies në AFP”. – Udhëzues metodologjik për hartimin e kurrikulave të AFP-së në Shqipëri. – Faqja zyrtare e AKAFPK-së : www.akafp.gov.al . – Manuali “Bazat e Didaktikës në AFP” , i rishikuar.
---	---

pedagogjisë dhe mësimdhënies; • të demonstrojë përdorimin me teknikë efektive të medieve pedagogjike në proces mësimor, sipas lëndëve ose modulit përkatës; • të vlerësojë ndikimin e medieve mësimore në motivimin, përfshirjen dhe performancën e nxënësve. • të përzgjedhë mediet pedagogjike të veçanta për një seancë mësimore të dhënë, nga lënda ose moduli përkatës; • të argumentojë zgjedhjet e bëra; • të përzgjedhë për procesin mësimor media digjitale të qëndrueshme, etike dhe të sigurt.	
Kompetenca IV: “Planifikimi i procesit mësimor në AFP”	Literatura e rekomanduar
Mësimdhënësi i kulturës profesionale teorike dhe/ose praktike në AFP duhet të jetë i aftë: • të shpjegojë kuptimin dhe parimet ku mbështetet planifikimi i procesit mësimor; • të rendisë faktorët që konsiderohen gjatë planifikimit të procesit mësimor teorik ose praktik (rezultatet e të nxënit, kualifikimi, profili profesional, tregu i punës, karakteristikat e nxënësve, burimet, mjedisi) • të tregojë si ndikojnë këto faktorë në planin efektiv të procesit mësimor; • të përshkruajë veçoritë e procesit mësimor në arsimin profesional, duke theksuar lidhjen teori–praktikë; • të rendisë fazat kryesore të planit të procesit mësimor teorik dhe praktik; • të dallojë planifikimin, afatmesëm dhe afatshkurtër në AFP; • të hartojë planin e një seance mësimore (teorike ose	– Urdhër nr 220, datë 16.09.2020 për miratimin e rregullores “ Për zbatimin e praktikave profesionale në biznes në kuadër të ndjekjes së programeve të AFP-së në institucionet publike të arsimit dhe formimit profesional”. – Udhëzues AKAFPK për shkollat profesionale publike (në kuadrin e fillimit të vitit shkollor). – Broshurat “Arsimi dhe Formimi Profesional” , nr. 1–12, AKAFPK. – Fjalori i Arsimit dhe Formimit Profesional. – Broshura “Standardet e mësimdhënies në AFP”. – Udhëzues metodologjik për hartimin e kurrikulave të AFP-së në Shqipëri. – Faqja zyrtare e AKAFPK-së : www.akafp.gov.al . – Skeletkurrikulat https://www.akafp.gov.al/tabela-e-struktures-se-skeletkurrikula/ – Manuali “Bazat e Didaktikës në AFP” , i rishikuar. – Urdhër i MAS nr.589, datë 16.10.2023 “për miratimin e

praktike) sipas fazave kryesore dhe në përputhje me parimet bazë të planifikimit; • të hartojë planin e një seance mësimore që ndërthur kompetencat profesionale dhe të përgjithshme, aftësi digjitale, praktikat e qëndrueshme, aftësitë e gjelbra dhe kërkesat e tregut të punës; • të planifikojë procesin mësimor duke përfshirë elementë didaktikë që zhvillojnë aftësi të buta, që zhvillojnë aftësitë e tyre dhe garantojnë qasjen e personalizuar për nxënësit me nivele, stile të nxënës dhe nevojat të ndryshme; • të hartojë planin dhe të argumentojë përzgjedhjet e bëra në lidhje me përmbajtjen, metodat, mjetet dhe analizat; • të analizojë në mënyrë kritike dhe krijuese planin e një seance mësimore të dhënë, duke rekomanduar përmirësime konkrete; • të reflektojë mbi planin si proces dinamik dhe të përmirësueshëm; • të hartojë projekte kurrikulare dhe ndërkurrikulare, ndërlëndore dhe/ose ndërmodulare; • të përzgjedhë mjetet, mediat didaktike dhe/ose digjitale, si dhe materiale të tjera për realizimin e një seance mësimore teorike ose praktike; • të plotësojë regjistrin elektronik me të dhënat e kërkuara në platformën SMIP sipas rregullave të përcaktuara; • të zbatojë koherencë ndërmjet objektivave, përmbajtjeve, metodave dhe analizave; • të hartojë veprimtaritë që do të realizohen në biznes, duke u bazuar në udhëzimet dhe dokumentet kurrikulare të AFP-së.	rregullores për përdorimin e sistemit të menaxhimit të informacionit parauniversitar” (SMIP). —
---	---

FUSHA: VLERËSIMI I TË NXËNIT NË AFP

Kompetenca I: “Parimet, metodat dhe instrumentet dhe llojet e vlerësimit në AFP”

Literatura e rekomanduar

Mësimdhënësi i kulturës profesionale teorike dhe/ose praktike në AFP duhet të jetë i aftë:

- të shpjegojë kuptimin e vlerësimit të nxënësve/kursantëve si proces sistematik i matjes së arritjeve të të nxënit;
- të përshkruajë llojet e vlerësimit në AFP sipas kriterëve të caktuara;
- të shpjegojë veçoritë e secilit lloj vlerësimi në kontekstin e arsimit profesional dhe formimit praktik;
- të theksojë rolin e vlerësimit formativ në zhvillimin e shprehive profesionale dhe përmirësimin e performancës gjatë praktikës;
- të tregojë veçoritë specifike të vlerësimit të nxënësve/kursantëve në AFP, me fokus në vlerësimin e shprehive praktike, respektimin e rregullave të sigurisë teknike, cilësinë e punës së kryer, korrektësinë profesionale dhe përgjegjshmërinë në punë;
- të shpjegojë rëndësinë e vlerësimit të performancës reale në kontekstin e profesionit dhe të tregut të punës;
- të interpretojë udhëzimet dhe aktet nënligjore që rregullojnë vlerësimin e nxënësve/kursantëve në AFP;
- të zbatojë kërkesat ligjore dhe institucionale për organizimin e vlerësimit dhe provimeve në AFP;
- të shpjegojë përgjegjësitë e mësimdhënësit në procesin e vlerësimit, dokumentimit dhe raportimit të rezultateve;
- të përdorë platforma digjitale për teste, quice, detyra dhe

- Udhëzim i ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr. 759, datë 30.9.2024 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit”.
- Udhëzimi 15, datë 26.04.2019, për organizimin dhe zhvillimin e provimeve në AFP.
- Udhëzues i përvitshëm i AKAFPK për shkollat profesionale publike (në kuadrin e fillimit të vitit shkollor).
- Broshurat “Arsimi dhe Formimi Profesional”, nr. 1–12..
- Fjalori i Arsimit dhe Formimit Profesional.
- Broshura “Standardet e mësimdhënies në AFP”.
- Udhëzues metodologjik për hartimin e kurrikulave të AFP-së në Shqipëri.
- Faqja zyrtare e AKAFPK-së : www.akafp.gov.al .
- Manuali “Bazat e Didaktikës në AFP” , i rishikuar.
- Udhëzimet për zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore.
- Urdhër i MAS nr.589, datë 16.10.2023 “për miratimin e rregullores për përdorimin e sistemit të menaxhimit të informacionit parauniversitar” (SMIP).

vlerësime (Google Forms, Socrative, Moodle, Wordwall, Kahoot, SMIP); - të listojë format dhe metodat e vlerësimit të përdorura në AFP; - të dallojë instrumentet kryesore për vlerësimin e njohurive teorike, vlerësimin e shprehive praktike, vlerësimin e qëndrimeve dhe sjelljeve profesionale; - të demonstrojë shembuj konkretë të instrumenteve të vlerësimit të përdorura në lëndën ose modulin përkatës profesional; - të shpjegojë kuptimin e rubrikës së vlerësimit si instrument kompleks dhe transparent vlerësimi; - të përshkruajë strukturën e rubrikës së vlerësimit (kriteret, nivelet e performancës, përshkruesit); - të shpjegojë përdorimin e rubrikave për vlerësimin e njohurive, vlerësimin e shprehive praktike, vlerësimin e qëndrimeve dhe etikës profesionale; - të demonstrojë shembuj të rubrikave të vlerësimit të përshtatura për AFP.	
Kompetenca II: “Vlerësimi i njohurive në AP”	Literatura e rekomanduar
Mësimdhënësi i kulturës profesionale teorike dhe/ose praktike në AFP duhet të jetë i aftë: - të përzgjedhë metodat dhe instrumentet e përshtatshme të vlerësimit për situata të ndryshme mësimore, teorike dhe praktike, në përputhje me rezultatet e të nxënit të parashikuara në kurrikulë; - të konsiderojë, gjatë përzgjedhjes së instrumenteve të vlerësimit, nivelin e njohurive digjitale të nxënësve/kursantëve, zhvillimin e aftësive të buta (bashkëpunimi, komunikimi, përgjegjshmëria) dhe	– Manuali “Bazat e Didaktikës në AFP” , i rishikuar. – Udhëzues i përvitshëm i AKAFPK për shkollat profesionale publike (në kuadrin e fillimit të vitit shkollor). – Udhëzim i ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr. 759, datë 30.9.2024 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjen e njësive të zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit”.

aspektet e qëndrueshmërisë (aftësitë e gjelbra); • të shpjegojë mënyrat e organizimit të provimeve përfundimtare në AFP, si për komponentin teorik, ashtu edhe për atë praktik; • të shpjegojë përdorimin e instrumenteve të vlerësimit që masin njohuritë digjitale, aftësitë ndërpersonale dhe aftësinë për bashkëpunim në kontekst profesional; • të interpretojë rregullat dhe procedurat zyrtare për zhvillimin e provimeve dhe dokumentimin e rezultateve të vlerësimit; • të hartojë instrumente të thjeshta dhe të qarta të vlerësimit për nivele të ndryshme të njohurive të nxënësve/kursantëve, në përputhje me nivelin e kualifikimit profesional; • të hartojë instrumente vlerësimi që përfshijnë përdorimin e teknologjisë, vlerësimin e sjelljes bashkëpunuese dhe respektimin e parimeve të punës së qëndrueshme; • të hartojë lloje të ndryshme instrumentesh për vlerësimin e njohurive nga lënda ose moduli përkatës, duke evidentuar aftësitë digjitale, kompetencat ndërpersonale dhe aspektet mjedisore; • të hartojë instrumente komplekse të vlerësimit (rubrika), të përshtatura për vlerësimin e njohurive në AFP; • të integrojë në rubrikat e vlerësimit kritere që lidhen me aftësitë digjitale, aftësitë e buta dhe praktikën e qëndrueshme profesionale; • të llogarisë dhe interpretojë rezultatet e vlerësimit të nxënësve/kursantëve bazuar në rubrikat e hartuara; • të hartojë një test për vlerësimin përfundimtar të njohurive të nxënësve/kursantëve në lëndën profesionale përkatëse ose në komponentin teorik të modulit profesional;	– Udhëzues praktik për hartuesit e testeve me zgjedhje të shumëfishtë. – Udhëzimet për zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore.
---	---

• të përfshijë në test njësi vlerësimi që masin njohuritë mbi teknologjinë, kompetencat sociale dhe parimet e qëndrueshmërisë; • të zbatojë parimet e drejtësisë, objektivitetit dhe transparencës gjatë testimit përfundimtar; • të ndërtojë një plan të plotë vlerësimi për një proces mësimor të caktuar (temë, çështje, kapitull, modul ose rezultat të të nxënësve); • të hartojë instrumentet përkatëse të vlerësimit në përputhje me planin e vlerësimit dhe kërkesat kurrikulare; • të integrojë në planin e vlerësimit aftësitë digjitale, aftësitë e buta dhe aftësitë e gjelbra; • të analizojë në mënyrë kritike dhe krijuese instrumente komplekse të vlerësimit (rubrika), duke vlerësuar përshtatshmërinë dhe efektivitetin e tyre; • të vlerësojë ndikimin e njohurive digjitale, aftësive të buta dhe praktikave të qëndrueshme në rezultatet e vlerësimit; • të analizojë rezultatet e vlerësimit të një grupi nxënësish dhe të nxjerrë konkluzione të qarta, të argumentuara dhe të bazuara në të dhëna, për përmirësimin e procesit mësimor.	
Kompetenca III: “Vlerësimi i shprehisë praktike në AFP”	Literatura e rekomanduar
Mësimdhënësi i kulturës profesionale teorike dhe/ose praktike në AFP duhet të jetë i aftë: • të përzgjedhë metodat dhe instrumentet e duhura të vlerësimit për situata të ndryshme mësimore të shprehive praktike, në përputhje me rezultatet e të nxënësve të përcaktuara në kurrikulë; • të integrojë në procesin e vlerësimit aftësitë digjitale, aftësitë e buta dhe praktikën e qëndrueshme, në funksion të zhvillimit profesional të nxënësve/kursantëve;	– Manuali “Bazat e Didaktikës në AFP”, i rishikuar. – Udhëzues i përvitshëm i AKAFPK për shkollat profesionale publike (në kuadrin e fillimit të vitit shkollor). – Udhëzim i ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr. 759, datë 30.9.2024 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe

• të shpjegojë mënyrat e organizimit të provimeve përfundimtare të shprehive praktike në AFP, si në mjedisin shkollor ashtu edhe në mjedisin e punës; • të interpretojë rregullat dhe procedurat zyrtare për vlerësimin praktik, në përputhje me dokumentet kurrikulare dhe aktet nënligjore në fuqi; • të hartojë instrumente të thjeshta të vlerësimit për nivele të ndryshme të shprehive praktike të nxënësve/kursantëve, duke marrë parasysh sigurinë në punë, cilësinë e realizimit dhe ndikimin mjedisor të procesit të punës; • të hartojë lloje të ndryshme instrumentesh vlerësimi për shprehitë praktike të lëndës ose modulit përkatës profesional; • të hartojë instrumente komplekse të vlerësimit (rubrika) për shprehitë praktike dhe të llogarisë rezultatet e vlerësimit në mënyrë të drejtë dhe transparente; • të integrojë në rubrikat e vlerësimit kritere që lidhen me aftësitë digjitale, aftësitë ndërpersonale, sigurinë teknike dhe praktikën e qëndrueshme; • të hartojë lista kontrolli dhe udhëzues përmbushjeje për vlerësimin përfundimtar të shprehive praktike, duke evidentuar standardet profesionale, digjitale dhe mjedisore; • të analizojë në mënyrë kritike dhe krijuese instrumente komplekse vlerësimi (rubrika), duke vlerësuar edhe aspektet e aftësive të buta dhe praktikave të gjelbra; • analizojë rezultatet e vlerësimit të një grupi nxënësish për një shprehje praktike dhe të nxjerrë konkluzione të argumentuara për përmirësimin e procesit mësimor; • të demonstrojë shembuj të llogaritjes së mesatareve të ponderuara, duke marrë parasysh kreditet, koeficientët dhe peshën e komponentit praktik;	zhvillimit të vazhduar profesional të personelit”. – Urdhër nr 220, datë 16.09.2020 për miratimin e rregullores “për zbatimin e praktikave profesionale në biznes në kuadër të ndjekjes së programeve të afp- së në institucionet publike të arsimit dhe formimit profesional”. – Udhëzim Nr.1090, datë 12.12.2024 “Për procedurat e planifikimit dhe zbatimin e arsimit dhe formimit profesional në formën e dyfishtë”.
---	--

• të interpretojë referencat ligjore dhe nënligjore për vlerësimin e nxënësve/kursantëve gjatë praktikave profesionale në biznes; • të vlerësojë shprehitë praktike të nxënësve/kursantëve në mjedisin dual, duke përdorur metoda dhe instrumente të përshtatshme për matjen e performancës profesionale në kontekstin real të punës, njohurive digjitale të përdorura gjatë aktivitetit praktik të aftësive ndërpersonale dhe bashkëpunuese, zbatimit të praktikave të qëndrueshme dhe aftësive të gjelbra; • të analizojë rezultatet e vlerësimit në biznes dhe të nxjerrë konkluzione për përmirësimin e procesit mësimor dhe zhvillimin profesional të nxënësve.	
Kompetenca IV: “Vlerësimi i qëndrimeve dhe vlerave në AFP”	Literatura e rekomanduar
Mësimdhënësi i kulturës profesionale teorike dhe/ose praktike në AFP duhet të jetë i aftë: • të përzgjedhë metodat dhe instrumentet e përshtatshme për vlerësimin e qëndrimeve dhe vlerave profesionale të nxënësve/kursantëve, në përputhje me rezultatet e të nxënësve të përcaktuara në kurrikulë; • të integrojë në procesin e vlerësimit dimensionet e aftësive ndërpersonale, njohurive digjitale dhe praktikave të qëndrueshme; • të hartojë instrumente të thjeshta vlerësimi për nivele të ndryshme të qëndrimeve dhe vlerave të nxënësve/kursantëve (p.sh. lista kontrolli, fletë vëzhgimi, pyetësorë reflektues); • të hartojë lloje të ndryshme instrumentesh për vlerësimin e qëndrimeve dhe vlerave nga lënda ose moduli profesional përkatës, duke marrë parasysh specifikat e AFP-së,	– Manuali “Bazat e Didaktikës në AFP” , i rishikuar. – Udhëzues i përvitshëm i AKAFPK për shkollat profesionale publike (në kuadrin e fillimit të vitit shkollor). – Udhëzim i ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr. 759, datë 30.9.2024 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimit e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit”. – Urdhër nr 220, datë 16.09.2020 për miratimin e rregullores “për zbatimin e praktikave profesionale në biznes në kuadër të ndjekjes së programeve të afp- së në institucionet publike të arsimit dhe formimit profesional”. – Udhëzim Nr.1090, datë 12.12.2024 “Për procedurat e planifikimit dhe zbatimin e arsimit dhe formimit profesional në formën e dyfishtë”.

përfshirë mësimin në formën e dyfishtë (dual) dhe praktikat profesionale në biznes; • të hartojë njësi testi dhe instrumente për vlerësimin përfundimtar të qëndrimeve dhe vlerave të nxënësve/kursantëve në lëndën profesionale përkatëse ose në aspektet teorike të modulit profesional; • të integrojë në vlerësimin përfundimtar instrumente të përshtatura për mësimin në formën e dyfishtë dhe praktikat profesionale në biznes; • të analizojë rezultatet e vlerësimit të qëndrimeve dhe vlerave të nxënësve/kursantëve dhe t'i përdorë ato për përmirësimin e procesit mësimor dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional; • të reflektojë mbi rolin e vlerësimit të qëndrimeve dhe vlerave në formimin e identitetit profesional të nxënësve/kursantëve dhe në përgatitjen e tyre për tregun e punës.	
FUSHA: KRIJIMI I ATMOSFERËS POZITIVE NË PROCESIN MËSIMOR	
Kompetenca I: “Zbatimi i rregullave të etikës dhe të komunikimit si elemente të domosdoshme në të gjithë punën e mësimdhënësit”	Literatura e rekomanduar

Mësimdhënësi i kulturës profesionale teorike dhe/ose praktike në AFP duhet të jetë i aftë: • të njohë dhe zbatojë rregullat e etikës dhe të sjelljes profesionale në marrëdhënie me drejtuesit e institucionit arsimor, stafin pedagogjik, nxënësit/kursantët, prindërit dhe komunitetin; • të veprojë dhe të marrë vendime në përputhje me parimet etike dhe normat profesionale gjatë veprimtarisë brenda dhe jashtë institucionit arsimor; • të demonstrojë përgjegjshmëri, korrektësi dhe integritet profesional në ushtrimin e detyrës së tij mësimdhënëse. • Të zbatojë rregullat e etikës dhe të komunikimit profesional në bashkëpunimin me bizneset, partnerët socialë dhe mentorët në kuadër të arsimit dhe formimit profesional në formën e dyfishtë (dual); • të ndërveprojë në mënyrë profesionale, të strukturuar dhe transparente me mentorët e bizneseve për të garantuar zhvillimin e suksesshëm të praktikave profesionale dhe të mësimin në punë; • të marrë vendime etike dhe profesionale në situata bashkëpunimi me përfaqësuesit e bizneseve, duke respektuar rolet, përgjegjësitë dhe standardet institucionale; • të përshkruajë veçoritë e perceptimit pamor dhe dëgjimor të nxënësve/kursantëve dhe ndikimin e tyre në procesin mësimor; • të njohë dhe zbatojë teknika për kapërcimin e barrierave të komunikimit në procesin mësimor teorik dhe praktik; • të përdorë teknika efektive të komunikimit verbal dhe joverbal për të krijuar një mjedis mësimor të sigurt, mbështetës dhe motivues; • të dallojë dhe zbatojë standardet bazë të komunikimit profesional të mësimdhënësit në AFP;	– Kodi i Etikës së Mësimdhënësve në Arsimin Parauniversitar. – Manuali “Bazat e Didaktikës në AFP” , i rishikuar. – Urdhër nr.46 datë 24.07.2020 “Për standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar”. – Udhëzues dhe dokumente zyrtare të AKAFPK-së për kualifikimin e mësimdhënësve të AFP-së. – Materiale udhëzuese për bashkëpunimin me biznesin dhe mentorët në sistemin dual – Literaturë dhe materiale burimore mbi etikën, komunikimin dhe menaxhimin e marrëdhënieve me nxënësit, mentorët e biznesit dhe komunitetin.
---	--

• të marrë vendime etike dhe profesionale në situata të ndryshme komunikimi dhe bashkëpunimi me drejtuesit e shkollës, stafin mësimdhënës, nxënësit/kursantët, prindërit dhe komunitetin; • të demonstrojë profesionalizëm, transparencë, përgjegjësi dhe respekt në çdo ndërveprim institucional dhe profesional.	
Kompetenca II: “Zhvillimi i aftësive kyçe të nxënësve të rinj dhe të rritur”	Literatura e rekomanduar
Mësimdhënësi i kulturës profesionale teorike dhe/ose praktike në AFP duhet të jetë i aftë: • Të shpjegojë kuptimin e konceptit “aftësi kyçe” në kontekstin e Arsimit dhe Formimit Profesional; • të argumentojë rëndësinë e integritit të aftësive kyçe në përmbajtjet mësimore, në procesin mësimor dhe në praktikat profesionale në biznes; • të lidhë zhvillimin e aftësive kyçe me kërkesat e tregut të punës, mësimin gjatë gjithë jetës dhe zhvillimin e karrierës profesionale; • të zbatojë strategji fleksible të mësimdhënies që nxisin risitë, mendimin kritik, zgjidhjen e problemeve reale dhe zhvillimin e dijes praktike të nxënësve;	– Kodi i Etikës së Mësimdhënësve në Arsimin Parauniversitar. – Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Profesional. – Komisioni Evropian, DG Arsimit dhe Kultura (2011). – Udhëzimi për kualifikimin e mësimdhënësve të kulturës profesionale në AFP. – Vendim nr. 691, datë 6.11.2024, “Për përcaktimin e rregullave të veçanta që zbatohen për kontratën e mësimi të profesionit dhe përcaktimin e pagës minimale për mësimin e profesionit në arsimin dhe formimin profesional në formën e dyfishtë”. – Udhëzim nr. 1090, datë 12.12.2024, “Për procedurat e planifikimit dhe zbatimit të arsimit dhe formimit profesional në formën e dyfishtë”.

• të përzgjedhë metoda mësimore që mbështesin të nxënit aktiv, bashkëpunues dhe të orientuar drejt kompetencave; • të zbatojë strategji efektive për menaxhimin e kohës dhe planifikimin e aktiviteteve që krijojnë mundësi reale për zhvillimin e karrierës së nxënësve në vendin e punës dhe gjatë praktikave profesionale; • të jetë i hapur dhe aktiv në përdorimin e kolegëve, mentorëve të biznesit dhe profesionistëve të tjerë si burim mësimi, bashkëpunimi dhe frymëzimi për nxënësit; • të kontribuojë në zhvillimin dhe të nxënit e komunitetit profesional të shkollës, duke përfshirë bashkëpunimin me partnerët e biznesit në kuadër të arsimit dhe formimit profesional në formën e dyfishtë (dual); • të marrë pjesë në proceset e zhvillimit institucional dhe në ndarjen e praktikave të mira profesionale. • të angazhohet në zhvillimin e vazhdueshëm profesional për të rritur efikasitetin në mësimdhënie dhe për të përmirësuar ekspertizën në lëndën ose modulën që zhvillon; • të forcojë aftësitë pedagogjike, metodologjike dhe profesionale, duke reflektuar mbi praktikën e veta mësimore; • të shërbejë si model pozitiv për nxënësit në zhvillimin e aftësive kyçe, të nxënit social dhe emocional, si dhe të qëndrimeve profesionale; • të përdorë instrumente dhe metoda mësimore që mbështesin zhvillimin e të nxënit social, emocional dhe profesional të nxënësve; • të zhvillojë kompetencat kyçe të nxënësve, me theks të veçantë në aftësitë e shkrimit dhe leximit funksional, aftësitë numerike, aftësitë digjitale;	– Manuali “Bazat e didaktikës në AFP”, i rishikuar. – Literaturë dhe materiale burimore mbi zhvillimin e aftësive kyçe të nxënësve të rinj dhe të rritur. – https://www.portalishkollor.al/kuriozitet/mesimdhenia-me-baze-kompetence. – https://eurydice.eacea.ec.europa.eu/publications/developing-key-competences-school-europe-challenges-and-opportunities-policy
---	---

të lidhë këto kompetenca kyçe drejtpërdrejt me situata reale pune dhe praktikat profesionale në biznes.	
Kompetenca III: “Zbatimi i parimeve të barazisë, gjithëpërfshirjes, diversitetit dhe zhvillimit të qëndrueshëm në procesin mësimor”	Literatura e rekomanduar
Mësimdhënësi i kulturës profesionale teorike dhe/ose praktike në AFP duhet të jetë i aftë: - të shpjegojë kuptimin e koncepteve “barazi”, “mundë të barabarta”, “gjithëpërfshirje”, “persona me nevoja të veçanta”, “diversitet” në kontekstin e Arsimit dhe Formimit Profesional; - të shpjegojë dhe integrojë në mënyrë të qëndrueshme konceptet e barazisë, gjithëpërfshirjes, diversitetit, qëndrueshmërisë dhe aftësive digjitale në planifikimin dhe zhvillimin e procesit mësimor në AFP. - të demonstrojë, përmes shembujve konkretë, zbatimin e parimeve të barazisë, gjithëpërfshirjes, diversitetit, zhvillimit të qëndrueshëm dhe përdorimit të teknologjisë digjitale në procesin mësimor në AFP; - të krijojë një mjedis mësimor të sigurt, mbështetës, gjithëpërfshirës dhe ekologjikisht të qëndrueshëm, ku të gjithë nxënësit/kursantët ndihen të respektuar, të përfshirë dhe të motivuar për të mësuar. - të përfshijë të gjithë nxënësit/kursantët në projekte, aktivitete mësimore dhe veprimtari sociale që promovojnë diversitetin, barazinë, bashkëpunimin dhe përgjegjësinë mjedisore; - të aktivizojë nxënësit në iniciativa që synojnë përmirësimin e përfshirjes sociale, zhvillimin e aftësive të buta dhe zbatimin e praktikave ekologjike në mjedisin shkollor dhe	– Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2023–2030. – Plani Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021–2025. – Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm (dokumente përkatëse sektoriale). – Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Profesional. – Dokumente dhe udhëzime të AKAFPK mbi AFP, praktikat në biznes, modelin dual dhe përdorimin e teknologjisë digjitale në procesin mësimor. – Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me Ligjin nr. 56/2015, me Ligjin nr. 48/2018 dhe me Ligji nr. 44/2023. – Literatura dhe materiale burimore mbi barazinë, gjithëpërfshirjen, diversitetin, aftësitë e buta, qëndrueshmërinë dhe digjitalizimin në arsimin profesional.

profesional. - të kontribuojë në hartimin dhe zbatimin e politikave të institucionit arsimor dhe strategjive për parandalimin e diskriminimit, përjashtimit social dhe degradimit mjedisor; - të vlerësojë dhe respektojë diversitetin brenda dhe përtej grupeve etnike, kulturore dhe sociale në planifikimin dhe zhvillimin e procesit mësimor. - të përdorë metodologji inovative, përfshirë qasje digjitale dhe ndërdisiplinore, për të përforcuar të nxënit mbi gjithëpërfshirjen, barazinë, diversitetin dhe qëndrueshmërinë; - të ofrojë dhe sigurojë metodologji, burime mësimore dhe aktivitete praktike të përshtatura sipas parimeve të barazisë, gjithëpërfshirjes, diversitetit, zhvillimit të qëndrueshëm dhe përdorimit të teknologjisë digjitale.	
FUSHA: MJEDISI DHE MËSIMI DIGJITAL NË AFP	
Kompetenca I: “Përgatitja dhe mirëmbajtja e mjedisit dhe mjeteve për mësimin digjital në AFP”	Literatura e rekomanduar
Mësimdhënësi i kulturës profesionale teorike dhe/ose praktike në AFP duhet të jetë i aftë: - të shpjegojë kuptimin e koncepteve “mjedis digjital”, “mjetet digjitale” dhe “mësim digjital”, në lidhje me procesin mësimor teorik dhe praktik në AFP; - të përshkruajë rolin e mjedisit dhe mjeteve digjitale në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënit profesional; - të identifikojë dhe analizojë veçoritë e përgatitjes dhe	– Manuali “Bazat e Didaktikës në AFP”, i rishikuar. – Udhëzues i përvitshëm i AKAFPK për shkollat profesionale publike (në kuadrin e fillimit të vitit shkollor). – Urdhër nr.46 datë 24.07.2020 “Për standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar”. – Udhëzues dhe dokumente zyrtare të AKAFPK-së për kualifikimin e mësimdhënësve të AFP-së https://www.akafp.gov.al/kualifikimi-i-

përdorimit të mjedisit dhe mjeteve digjitale në AFP; • të argumentojë përparësitë dhe kufizimet e përdorimit të mjedisit dhe mjeteve digjitale në mësimin teorik dhe praktik; • të demonstrojë shembuj konkretë të përdorimit të mjedisit dhe mjeteve digjitale për një njësi mësimore nga lënda ose moduli profesional përkatës; • të përgatisë dhe mirëmbajë pajisjet dhe mjetet digjitale të nevojshme për zhvillimin efektiv të procesit mësimor në një seancë mësimore të lëndës ose modulit përkatës; • të menaxhojë mjedisin dhe mjetet digjitale në mënyrë efikase dhe të sigurt, duke respektuar parimet e mbrojtjes së të dhënave personale dhe sigurisë digjitale; • të zbatojë rregullat bazë të etikës dhe sigurisë në përdorimin e teknologjisë digjitale në mjedisin mësimor; • të përgatisë materiale mësimore digjitale (prezantime, video, udhëzime, fletë pune online) që mbështesin të nxënit teorik dhe praktik; • të integrojë praktikat digjitale në përgatitjen e nxënësve/kursantëve për zhvillimin e aftësive kyçe dhe profesionale, përfshirë përdorimin e teknologjisë në mjedise reale pune dhe në arsimin në formë të dyfishtë.	vazhduar-i-mesimdhenesve/ – Literaturë dhe materiale burimore mbi mjedisin digjital mësimor dhe përdorimin e teknologjisë në arsimin profesional. – Materiale mbi sigurinë digjitale, mbrojtjen e të dhënave dhe etikën në përdorimin e teknologjisë në arsim.
Kompetenca II: “Përgatitja e materialeve didaktike digjitale për mësimin digjital në AFP”	Literatura e rekomanduar

Mësimdhënësi i kulturës profesionale teorike dhe/ose praktike në AFP duhet të jetë i aftë: • të shpjegojë kuptimin e termit “materiale didaktike digjitale” në kontekstin e mëimit teorik dhe praktik në AFP; • të argumentojë rolin dhe rëndësinë e materialeve didaktike digjitale në përmirësimin e cilësisë së procesit mësimor dhe në zhvillimin e kompetencave profesionale të nxënësve/kursantëve; • të identifikojë dhe klasifikojë llojet dhe formatet kryesore të materialeve mësimore digjitale të përdorura në mësimin teorik dhe praktik (prezantime digjitale, video mësimore, simulime, fletë pune online, platforma mësimore, etj.); • të shpjegojë veçoritë dhe përdorimin e secilit format në funksion të objektivave mësimore dhe rezultateve të të nxënësve; • të përdorë dhe zbatojë teknika bashkëkohore për përgatitjen dhe përdorimin e materialeve mësimore digjitale në mësimin teorik dhe praktik; • të përzgjedhë dhe përdorë mjete dhe platforma digjitale të përshtatshme për krijimin e materialeve mësimore, duke respektuar parimet didaktike dhe standardet e AFP-së; • të demonstrojë shembuj konkretë të përdorimit të materialeve didaktike digjitale në një njësi mësimore nga lënda ose moduli profesional përkatës; • të integrojë materialet digjitale në procesin mësimor teorik, praktik dhe në mësimin në formën e dyfishtë (dual), përfshirë praktikat profesionale në biznes; • të përdorë materialet digjitale për të mbështetur zhvillimin e aftësive profesionale, digjitale dhe të buta të	– Manuali “Bazat e Didaktikës në AFP” , i rishikuar). – Udhëzues për shkollat profesionale publike (në kuadrin e fillimit të vitit shkollor. – Udhëzues për fillimin e vitit shkollor (MAS/AKAFPK). – Udhëzues për mësimin dhe vlerësimin në kushtet e shtëpisë, për lëndët dhe modulet profesionale në Arsimin Profesional, Tiranë, 23.03.2020. – Literaturë dhe materiale burimore që trajtojnë çështje të mëimit digjital dhe përdorimin e mjeteve digjitale.
---	--

nxënësve/kursantëve; - të përzgjedhë burime të përshtatshme dhe të besueshme informacioni për përgatitjen e materialeve mësimore digjitale; - të vlerësojë cilësinë, vlefshmërinë dhe përshtatshmërinë e burimeve të informacionit në funksion të përmbajtjes mësimore dhe nevojave të nxënësve/kursantëve.	
Kompetenca III: “Përgatitja e instrumenteve dhe kryerja e vlerësimit digjital të nxënësve dhe kursantëve”.	Literatura e rekomanduar
Mësimdhënësi i kulturës profesionale teorike dhe/ose praktike në AFP duhet të jetë i aftë: - të shpjegojë kuptimin e konceptit të vlerësimit digjital dhe rolin e tij në mësimdhënien bashkëkohore, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme; - të argumentojë rëndësinë e vlerësimit digjital për matjen objektive të kompetencave profesionale, digjitale dhe të buta të nxënësve/kursantëve; - të hartojë dhe përdorë instrumente vlerësimi digjitale që matin në mënyrë të drejtë, të besueshme dhe të krahasueshme nivelin e përmbushjes së rezultateve të të nxënësve dhe kompetencave profesionale; - të përzgjedhë dhe përdorë platforma digjitale të vlerësimit, si MS Teams, Moodle, Mesovet, Google Forms etj., për zhvillimin e testeve dhe vlerësimeve digjitale; - të integrojë praktika miqësore me mjedisin në procesin e vlerësimit digjital, përmes reduktimit të printimeve dhe menaxhimit efikas të burimeve digjitale; - të dallojë dhe analizojë mundësitë, formatet dhe variacionet e testeve digjitale për qëllime të ndryshme mësimore, të	– Manuali “Bazat e Didaktikës në AFP” , (i rishikuar). – Udhëzues për shkollat profesionale publike (në kuadrin e fillimit të vitit shkollor). – Udhëzues për fillimin e vitit shkollor (MAS/AKAFPK). – Udhëzues për mësimin dhe vlerësimin në kushtet e shtëpisë, për lëndët dhe modulet profesionale në Arsimin Profesional, Tiranë, 23.03.2020. – Literaturë dhe materiale burimore që trajtojnë çështje të mësimin digjital dhe përdorimin e mjeteve digjitale. – Manuale të përdorimit të platformave online.

përshtatura sipas platformave dhe programeve të përdorura; - të dallojë veçoritë e testeve të zhvilluara në mjedis online (Internet) dhe në mjedis të mbyllur (Local Area Network – LAN); - të identifikojë dhe përshkruajë lloje të ndryshme të njësive (pyetjeve) të testeve digjitale (me zgjedhje të shumëfishtë, përgjigje të shkurtër, përputhje, raste studimore, etj.), duke demonstruar përdorimin e tyre pedagogjik efektiv; - të analizojë veçoritë e përdorimit të instrumenteve të vlerësimit digjital në mjedisin mësimor digjital, duke marrë masa për shmangien e manipulimit, kopjimit dhe hakërimit; - të përdorë instrumente të vlerësimit digjital duke garantuar mbrojtjen e të dhënave personale, sigurinë digjitale dhe respektimin e etikës profesionale; - të përdorë mjetet analitike dhe raportet e rezultateve të platformave digjitale për të monitoruar progresin e nxënësve/kursantëve; - të analizojë të dhënat e vlerësimit digjital për të personalizuar procesin e vlerësimit dhe për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies në format online, të kombinuar (blended) ose të sinkronizuar.	
Kompetenca IV: “Realizimi i mësimi online dhe të kombinuar (blended) dhe përfshirja në komunitetet dhe rrjetet profesionale të praktikave online”	Literatura e rekomanduar
Mësimdhënësi i kulturës profesionale teorike dhe/ose praktike në AFP duhet të jetë i aftë: - të dallojë formatet kryesore të mësimi online, të kombinuar (blended) dhe të sinkronizuar/asinkron, si dhe veçoritë e zbatimit të tyre në AFP; - të shpjegojë kushtet pedagogjike, teknike dhe organizative	– Manuali “Bazat e Didaktikës në AFP” , i rishikuar). – Udhëzues i përvitshëm i AKAFPK për shkollat profesionale publike (në kuadrin e fillimit të vitit shkollor). – Udhëzues i përbashkët për fillimin e vitit shkollor (MA/MEI). – Udhëzues për mësimin dhe vlerësimin në kushtet e shtëpisë, për lëndët dhe

për realizimin efektiv të mësimin online dhe të kombinuar në arsimin profesional; • të zhvillojë dhe zbatojë forma efektive të mësimdhënies online dhe të kombinuar, duke përdorur platforma digjitale, metoda pedagogjike inovative dhe aktivitete interaktive për rritjen e angazhimit të nxënësve/kursantëve; • të zbatojë teknika të planifikimit dhe praktikimit të formateve të ndryshme të mësimin online dhe blended, në përputhje me rezultatet e të nxënësve dhe kërkesat e AFP-së; • të ilustrojë me shembuj praktikë përgatitjen dhe zhvillimin e mësimin online dhe të kombinuar për një njësi ose seancë mësimore nga lënda/moduli përkatës; • të përdorë internetin, platformat digjitale dhe mjetet online për zhvillimin e procesit mësimor dhe për mbështetjen e të nxënësve gjatë gjithë jetës; • të tregojë rëndësinë e përdorimit të mediave digjitale dhe rrjeteve sociale në funksion të procesit mësimor në AFP, duke garantuar etikën, sigurinë, mbrojtjen e të dhënave dhe efektivitetin pedagogjik; • të përdorë komunitetet e praktikës dhe rrjetet profesionale online për zhvillimin e vazhduar profesional dhe shkëmbimin e përvojës midis mësimdhënësve të AFP-së; • të marrë pjesë aktive në rrjetet profesionale online për ndarjen e praktikave të mira, inovacioneve pedagogjike dhe për rritjen e bashkëpunimit ndërmjet mësimdhënësve, institucioneve dhe partnerëve të tjerë profesionalë; • të kontribuojë në ndërtimin dhe zhvillimin e komuniteteve profesionale online në nivel lokal, kombëtar dhe evropian.	modulet profesionale në Arsimin Profesional, Tiranë, 23.03.2020. – Literaturë dhe materiale burimore që trajtojnë çështje të mësimin digjital dhe përdorimin e mjeteve digjitale. – Manuale të përdorimit të platformave online. Dokumentacioni orientues evropian – Manuali për Edukimin e Qytetarisë Digjitale, Këshilli i Evropës. – DigCompEdu – Korniza Evropiane për Kompetencat Digjitale të Edukatorëve. – Plani Evropian i Veprimit për Arsimin Digjital (2021–2027). – EQAVET – Korniza Evropiane e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin dhe Formimin Profesional. – Erasmus+ – Parimet dhe praktikat e mësimin online dhe blended.
--	---

FUSHA: ZHVILLIMI PROFESIONAL NË PROFESIONIN PËRKATËS

Kompetenca I: “Kompetenca intelektuale dhe pedagogjike”	Literatura e rekomanduar
Mësimdhënësi i kulturës profesionale teorike dhe/ose praktike në AFP duhet të jetë i aftë: • të integrojë njohuritë kritike, reflektive dhe profesionale në procesin mësimor dhe në veprimtarinë praktike profesionale; • të reflektojë mbi mbi përmirësimin e tij në mësimdhënie; • të përshtasë njohuritë teorike me situatat reale profesionale dhe me nevojat e nxënësve të rinj dhe të rritur; • të zbatojë parimet pedagogjike të punës me nxënësit/kursuesit, të lidhura me respektin, besimin dhe bashkëpunim; • të nxisë përvetësimin e njohurive nga nxënësit përmes mësimiit aktiv, reflektiv dhe të veprimtarisë profesionale; • të nxisë autonominë e nxënësve dhe përparimin për të nxënëin e tyre profesional; • të analizojë, sintetizojë dhe krahasojë informacionin nga burime të ndryshme; • të përdorur të menduarit kritikë dhe inteligjencën profesionale në arsimin e mësimëve teorike dhe praktike profesionale; • të nxisë të menduar në kritik të nxënësve përmes pyetjeve analitike, situatave problemore dhe rasteve studimore nga praktika profesionale; • të hartojë standarde lëndore në lidhje me kurrikulën e AFP-së duke i kushtuar vëmendje tregut të punës; • të përcaktojë kriteret të qarta, të matshme dhe të arritshme;	– Manuali “Bazat e didaktikës në AFP”, i rishikuar. – Standardet e mësimdhënësit të kulturës së përgjithshme në AFP, i rishikuar. – Broshurë Informative nr 5 i AKAFP. – Arsimi dhe Formimi Profesional nr 14.

• të zbatojë koherencë ndërmjet objektivave mësimore, përmbajtjeve, dhe metodave; • të integrojë elementet e sistemit të arsimit të dyfishtë në seancat mësimore gjatë vitit shkollor; • të lidhë përmbajtjet mësimore me studim të punës; • të përdori situata reale pune, shpjegime dhe kompetenca profesionale si pjesë e mësimdhënies; • të integrojë në mësim procese reale profesionale dhe teorike nga biznesi; • të hartojë standarde lëndore/ose modulare dhe profesionale të harmonizuara me kualifikimet përkatëse; • të përcaktojë kritere të qarta, të matshme dhe të zbatueshme për vlerat e standardeve; • të përdorë standarde si kriteret për përmirësimin e mësimdhënies; • të përmirësojë njohuritë pedagogjike dhe profesionale; • të angazhohet në rrjetet profesionale për rritjen e efektivitetit në mësimdhënie; • të përdorë reflektimin profesional dhe studimin e praktikave të AFP-së si instrument zhvillimi.	
Kompetenca II: “Kompetenca operative”	Literatura e rekomanduar
Mësimdhënësi i kulturës profesionale teorike dhe/ose praktike në AFP duhet të jetë i aftë: • të kryejë veprimtari që lidhen me aftësitë parashikuese, projektuese dhe lëndore, duke aplikuar njohuritë teorike dhe praktike në mënyrë sistematike, të praktikave profesionale dhe efektive; • të përshtatë punën profesionale me situatën reale dhe me kontekstin e arsimit profesional;	– Lista kombëtare e kualifikimeve në AFP. https://www.akafp.gov.al/lista-kombetare-e-kualifikimeve/ – Manuali “Bazat e didaktikës në AFP”, i rishikuar. – Arsimi dhe Formimi Profesional, nr 13. – Dokumente dhe udhëzime të AKAFPK-së mbi arsimin profesional dhe orientimin e tyre.

• të demonstrojnë aftësitë operative në zgjidhjen e punës praktike që lindin gjatë procesit mësimor dhe formimit profesional; • të përshkruajë dhe zbatojë veprimtari që mbështesin kualifikimin profesional të nxënësve/kursantëve sipas profilit të përzgjedhur; • të përshtasë përmbajtjen mësimore me standardet profesionale dhe kushtet reale të punës të punës; • të kontribuojë në përditësimin e përmbajtjeve mësimore në funksion të zhvillimit të teknologjisë dhe profesionale; • të ilustrojë me konkrete orientimin e nxënësve për profesionin, në drejtimin dhe profilin profesional përkatës; • të nxisë nxënësit të kuptojnë rrugët e zhvillimit profesional dhe mundësitë e punësimit; • të nxisë vetëdijen profesionale dhe planin e punës që në fazat e hershme të formimit; • të marrë pjesë aktive në aktivitete lidhur me njohuritë në profesionin përkatës; • të ndjekë praktika profesionale bashkëkohore dhe trajnime mbi zhvillimin teknologjik që kanë lidhje me fushën e tij; • të reflektojë mbi rritjen profesionale për të ndjekur orë mësimore në mësimdhënie dhe trajnime profesionale; • të zbatojë metodologjinë e organizimit të zbatimit të planifikimit dhe të plotë e procesit mësimor në AFP; • të përdorë strategji fleksibile dhe elemente të improvizimit pedagogjik për përballimin e situatave të ndryshme mësimore dhe sfida në klasë ose në mjedisin praktik; • të reagojë në mënyrë profesionale ndaj ndryshimeve, kufizimeve ose nevojave të paparashikuara gjatë procesit mësimor; • të përdorimi njohurive operative për të forcuar marrëdhëniet	
---	--

ndërmjet arsimit profesional dhe punës; - të kontribojë në përfshirjen e aktorëve të tjerë të sistemit (biznese, mentore, institucione) për përmirësimin e formimit profesional; - të kontribojë në bashkëpunimin e nxënësve për integrimin e mjedisit në kushtet e punës reale.	
FUSHA: ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE	
Kompetenca I: “Zbatimi i rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe”	Literatura e rekomanduar
Mësimdhënësi i kulturës profesionale teorike dhe/ose praktike në AFP duhet të jetë i aftë: - të njohë rregulloren bazë dhe të avancuar të drejtshkrimit të standardit të gjuhës shqipe; - të dallojë normën letrare nga përdorimet dialektore, bisedore ose jo standarde; - të njohë rregullat e shkrimit të drejtë të fjalëve, trajtave gramatikore, shenjave të pikësimit dhe përdorimit të shkronjave të mëdha; - të demonstrojë korrektësinë e rregullave të drejtshkrimit gjatë zhvillimit të veprimtarive mësimore; - të aplikojë me saktësi normën e drejtshkrimit në lidhjen e materialeve mësimore, planeve, testeve dhe dokumentacionit pedagogjik; - të shërbejë si model gjuhësor për nxënësit/kursantët për mësimin e gjuhës shqipe standarde; - të zbatojë rregullat e drejtshkrimit në komunikimin zyrtar dhe institucional (shkresa, njoftime, raporte, e-mail-e	– Drejtshkrimi i gjuhës shqipe, Akademia e Shkencave të Shqipërisë. – Literaturë udhëzues metodikë për ndryshimet e rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe. – Fjalor për Arsimin dhe Formimin Profesional, Pajtim Bejtja, Maksim Konini, Alqi Mustafaj. – Fjalorë normativë dhe burime zyrtare të gjuhës shqipe.

zyrtare); • të demonstrojë korrektësinë gjuhësore në dokumentacionin administrativ dhe profesional; • të demonstrojë qartësi, saktësi dhe profesionalizëm në të gjitha format e komunikimit të shkruar; • të identifikojë dhe korrigjojë gabime drejtshkrimore në materiale mësimore dhe dokumente profesionale; • të përdorë burime gjuhësore (fjalorë, drejtshkrim, udhëzues) për verifikimin e formave të sakta; • të nxisë ndërgjegjësimin gjuhësor dhe kulturën e shkrimit korrekt të nxënësit/kursantët; • të zbatojë rregullat e drejtshkrimit edhe në terminologjinë profesionale të fushës përkatëse; • të përdorë procese korrekte të terminologjisë së AFP-së në materiale mësimore dhe dokumente zyrtare; • të kontribuojë në mësimin e gjuhës korrekte gjatë procesit dhe profesional.	
---	--

4. Model pyetjesh të provimit të kualifikimit për kategorinë “Mësues i kualifikuar” dhe “Mësues specialist”

1. Skeletkurrikula e Arsimit Profesional në Shqipëri është: 1 pikë
- A) me strukturë që ka si bazë lëndët mësimore.
 - B) me strukturë që ka si bazë modulet mësimore.
 - C) me strukturë të kombinuar.
 - D) me strukturë që ka si bazë projektet mësimore.
2. Bazuar në udhëzimin “Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve në AFP”, **NUK** mund të jetë anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Provimit Përfundimtar Praktik (KVPP) në ofruesin publik të AP-së: 1 pikë
- A) përfaqësues nga drejtoria e shkollës.
 - B) përfaqësues nga biznesi rajonal.
 - C) mësimdhënës i praktikave profesionale.
 - D) mësimdhënës i teorisë profesionale.
3. Në kurrikulën e Arsimit Profesional në nivel ofruesi në Shqipëri, bëjnë pjesë: 1 pikë
- A) programet e Kurseve të Unifikuara të Formimit Profesional.
 - B) planet mësimore të Arsimit Profesional.
 - C) skeletkurrikulat e kualifikimeve profesionale.
 - D) lista kombëtare e profesioneve.
4. Përzgjedhja e modulit/moduleve me zgjedhje të detyruar (nga lista e moduleve të ofruara në skeletkurrikul) bëhet nga vetë shkolla, duke konsideruar: 1 pikë
- A) materialin mësimor teorik.
 - B) numrin e nxënësve në klasë.
 - C) planin e mësimdhënies.
 - D) kërkesat e tregut rajonal të punës.
5. Koordinator për sigurimin e cilësisë në nivel ofruesi është: 1 pikë
- A) drejtori i institucionit ofrues të AFP.
 - B) një nga kryetarët e departamenteve/ekipeve lëndore.
 - C) përgjegjësi i Njesisë së Zhvillimit.
 - D) një nga përfaqësuesit e biznesit.
6. Objektivi specifik mësimor është i plotë kur përmban: 1 pikë
- A) veprimtarinë dhe objektin.
 - B) veprimtarinë, objektin dhe kushtet e kërkesat.

- C) objektin dhe kushtet e kërkesat.
D) veprimtarinë dhe kushtet e kërkesat.
7. Cila është forma më tipike e paraqitjes së përmbajtjes të lëndëve teorike profesionale, në planin e mësimdhënies së lëndës? 1 pikë
- A) Veprimtaria mësimore;
B) Çështja mësimore;
C) Rezultati mësimor;
D) Kërkesat për realizim.
8. Cila nga metodat mësimore të mëposhtme është më e përdorshme për mësimin e orientuar nga teoria? 1 pikë
- A) Diskutimi;
B) Loja me role;
C) Simulimi;
D) Demonstrimi.
9. Metoda mësimore është interaktive kur: 1 pikë
- A) mësuesi shpjegon dhe nxënësit dëgjojnë.
B) mësuesi shfrytëzon përvojat e nxënësve.
C) nxënësit nxiten të mësojnë vetë.
D) nxënësit punojnë në grupe.
10. Synimet e lëndëve teorike profesionale janë pjesë e: 1 pikë
- A) skeletkurrikulës.
B) planit vjetor të shkollës.
C) planit të orëve të lira.
D) planit edukativ.
11. Planifikim i mësimdhënies do të thotë: 1 pikë
- A) të ndërtosh në mënyrë strategjike orën e mësimin.
B) të vësh në zbatim parimet e mësimdhënies.
C) të përcaktosh kohën e çdo veprimtarie mësimore.
D) të planifikosh vlerësimin e nxënësve sipas niveleve.
12. Vlerësimi i produktit të punës që kryejnë nxënësit gjatë praktikës profesionale bëhet me: 1 pikë
- A) test të njohurive për produktin e realizuar.
B) pyetje – përgjigje për produktin e realizuar.
C) matje të parametrevë të produktit të realizuar.

D) test të procedurës së punës të realizuar.

13. Vlerësimi i shprehive praktike të nxënësve bazohet në:

1 pikë

- A) përmbajtjet mësimore.
- B) metodat mësimore.
- C) kushtet për vlerësim.
- D) kriteret e vlerësimit.

14. Cili nga instrumentet e mëposhtëm përdoret më së shumti për të vlerësuar nivelin e përvetësimit të njohurive?

1 pikë

- A) Pyetje–përgjigje me gojë;
- B) Lista e kontrollit;
- C) Projekti praktik;
- D) Studime të rasti;

15. Udhëzuesi i punës shërben si bazë për të ndërtuar:

1 pikë

- A) testin teorik.
- B) listën e kontrollit.
- C) planin e mësimdhënies.
- D) ditarin.

16. Cili nga llojet e vlerësimeve e ndihmon mësuesin të gjejë shkaqet e mangësive në arritjet e nxënësve?

1 pikë

- A) Vlerësimi diagnostikues;
- B) Vlerësimi i vazhdueshëm;
- C) Vlerësimi përfundimtar;
- D) Vlerësimi paraprak.

17. Përparësi e mësimit digjital është:

1 pikë

- A) mungesa e komunikimit ballë për ballë.
- B) mësimi i personalizuar.
- C) kufizimi në disiplina të caktuara.
- D) të shkaktuarit e izolimit shoqëror.

18. Realizimi i komunikimit midis mësuesit dhe nxënësit, gjatë një ore mësimore konsiston në:

1 pikë

- A) planifikimin e një ore mësimore.
- B) përgatitjen e materialeve mësimore.
- C) transmetimin e një mesazhi.

D) përzgjedhjen e bazës materiale.

19. Në procesin mësimor, krijon barrierë komunikimi:

1 pikë

- A) mirëkuptimi.
- B) motivimi.
- C) gjurmimi.
- D) gjuha e folur.

20. Reagimi i individëve ndaj situatave të ndryshme në kontekstin jetësor ose profesional konsiderohet:

1 pikë

- A) qëndrim.
- B) njohuri.
- C) shprehje.
- D) shkathtësi.

21. Shkruani 5 (pesë) nga dallimet e kurrikulës së arsimit profesional krahasuar me kurrikulën e arsimit të përgjithshëm.

5 pikë

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____
5. _____

22. Plotësoni vendin bosh me një nga shprehjet e mëposhtme:

1 pikë

_____ është një seri hapash të lidhur me njëri - tjetrin, që ndërmerren, për të përmbushur një detyrë pune (shërbim ose produkt).

“Koncepti; Procedura; Procesi; Kualifikimi”

23. Shënoni përbri çdo pohimi me (V) nëse pohimi është i vërtetë ose me (G) nëse pohimi është i gabuar.

5 pikë

- A. ____ Vlerësimi i nxënësve kërkon nga mësimdhënësi që të përshtasë teknikat e vlerësimit me situatën mësimore.
- B. ____ Një nga sfidat më të mëdha të mësimdhënësve është të mësojnë si të trajtojnë nxënësit kur japin përgjigje të gabuara.
- C. ____ Mësimdhënësi duhet të ketë rol absolut në vlerësimin e nxënësve.
- D. ____ Nota për modulin llogaritet si mesatare e ponderuar e vlerësimeve për çdo Rezultat të Nxënësit (RN).

- E. ____ Që vlerësimi të konsiderohet i besueshëm duhet që ai t'i referohet objektivave mësimore.
24. Hartoni tre objektiva mësimore sipas kërkesave të mëposhtme: 1 pikë
1. I referohet fushës njohëse:

2. I referohet fushës afektive:

3. I referohet fushës psikomotore:

25. Listoni 4 (katër) nga metodat mësimore që nxisin aktivizimin e nxënësve. 4 pikë
- a) _____
- b) _____
- c) _____
- d) _____
26. Rendisni 3 shkaqe të krijimit të barrierave në komunikimin me nxënësit në klasë: 3 pikë
- a) _____
- b) _____
- c) _____
27. Listoni dy nga kushtet që duhet të përmbushë mjedisi mësimor, në aspektin fizik. 2 pikë
- a) _____
- b) _____
28. Listoni dy nga përparësitë e përdorimit të multimedieve mësimore në procesin mësimor. 2 pikë
- a) _____
- b) _____
29. Pëgjigjuni pyetjeve të mëposhtme. 3 pikë
- a) Cila është një nga masat që ndërmerret për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm në ditët e sotme, sipas fushës suaj të ekspertizës? 1 pikë
- _____
- _____

b) Cilat janë dy nga risitë e digjitalizimit në fushën tuaj të ekspertizës?

2 pikë

1. _____

2. _____

30. Në fjalët/ grupfjalët e mëposhtme, identifikoni dy fjalët/ grupfjalët e shkruara gabim dhe shkruajini saktë ato.

2 pikë

Kompetencë; Demonstrim; Praktikë e pavarur; Standarte; Platformë digjitale.

a) _____

b) _____

5. Model i një seance mësimore të hapur për të fituar kategorinë “Mësues mjeshtër”

Model 1 - Seancë mësimore praktike

Dt. ____ 12. 2025

Drejtimi: ELEKTROTEKNIKË

Profili: Telekomunikacion

Moduli: Instalimi i rrjeteve wireless Kodi: M-12-1634- 20

Klasa: 12

RN 1: Nxënësi instalon dhe konfiguron dhënësin *wireless* (Access Point)

Objektivat mësimore:

Nxënësi në fund të orëve të mësimit duhet të jetë i aftë:

- të instalojë me saktësi fizike Pikën e Aksesit (AP) dhe të gjitha komponentët e saj (ushqimi, linja), duke kryer tokëzimin e domosdoshëm për sigurinë.
- të integrojë AP-në me pjesën tjetër të rrjetit dhënës, duke siguruar lidhje të menjëhershme dhe funksionale.
- të optimizojë sinjalin ,duke analizuar brezin e frekuencave dhe duke pozicionuar antenën për mbulim të plotë të klientëve.

Fjalë kyçe:

Stacioni bazë i transemitimit, këndi i rënies, diagrama e rrezatimit, frekuenca e kanalit, akses point, mbulimi me sinjal, RSSI.

Burimet: Materiale nga Interneti, portalet online të kompanive të akses pointe-ve wireless.

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Metoda mësimore/teknika dhe strategji: stuhi mendimi, simulim, demonstrim, punë në grupe, punë e pavarur individuale.

Veprimtaritë për 6 orë mësimore:

- Analizimi i vendndodhjes së klientit në lidhje me pikën e transmetimit
- Instalimi i AP në kullë
- Analizimi i brezit të frekuencave për të kontrolluar për interferenca të mundshme
- Pozicionimi i antenës horizontalisht dhe vertikalisht në mënyrë që të arrihet mbulimi me sinjal i të gjithë klientëve

Hapi i parë (20-25 minuta) - Zhvillimi i situatës së të nxënit

- ✓ Prezantohen veprimtaritë.
- ✓ Stuhi mendimi: Çfarë dini ju për rrjetet e wireless dhe akses pointet ?
- ✓ Mësuesi thekson rëndësinë e organizimit dhe sigurisë fizike nëpërmjet moralit të ngjarjes.

Një ditë, një zog i vogël fluturoi brenda laboratorit të teknologjisë për të kërkuar ngrohtësi dhe ushqim. Ai u përplas me disa pajisje elektronike dhe shkaktoi një zhurmë të madhe. Zogu u shqetësua dhe në panik përpiqej të gjejë rrugën e daljes, duke u lënduar pak.

Nxënësit diskutuan se çfarë duhet të bëjnë për të ndihmuar zogun, si mund të parandalohet dëmtimi i tij dhe i pajisjeve, dhe cilat masa sigurie janë të nevojshme kur punojmë me pajisje të ndjeshme.

Morali:

Në situata të papritura ose stresuese, duhet të veprojmë me kujdes dhe të mos shkaktojmë dëme të panevojshme. Reflektimi mbi sigurinë dhe kontrollin e situatave është i rëndësishëm për të mësuarit dhe për ruajtjen e ambientit të punës.


Hapi i dytë (25–30 minuta) – Demonstrimi i mjeteve dhe burimeve

- Mësuesi prezanton të gjitha pajisjet fizike (ONU, PoE, Antenat) dhe burimet digjitale (Laptopi, Portali: ispdesign.ui.com).



Hapi tretë (50–65 minuta) – Instalimi fizik dhe projektimi i mbulimit (realizohet nëpërmjet punës në grupe me nga 2-3 nxënës dhe simulimit)

- **Projektimi:** Nxënësit zgjedhin AP-në, përcaktojnë këndin e mbulimit, lartësinë dhe pozicionin duke përdorur portalin e simulimit.
- **Vrojtimi:** Mësuesi vërejt nxënësit për saktësinë e fiksimit të elementeve dhe thekson rëndësinë e kryerjes së tokëzimit.



Hapi i katërt (50–60 minuta) – Integrimi dhe konfigurimi funksional (Simulim/Punë e Pavarur me Laptop)

Nxënësit fokusohen te integrimi funksional:

- ✓ Konfigurimi i Parë: Hyrja në ndërfaqen e AP-së.
- ✓ Lidhja me Rrjetin Dhënës: Vendosja e parametrave të ndërfaqes (IP, VLAN, etj.), simulimi i lidhjes midis komponentëve (ONU -> PoE -> AP).
- ✓ Testimi i Funksionalitetit: Përdorimi i komandave bazë (ping ose test i shpejtësisë) për të konfirmuar lidhjen e menjëhershme dhe funksionale me rrjetin dhënës.

Hapi i pestë (40–50 minuta): Analiza dhe optimizimi përfundimtar i sinjalit (punë në grupe/diskutim)

- Analizimi i brezit të frekuencave (simulim ose demonstrim) për të kontrolluar interferencat e mundshme.
- Pozicionimi i detajuar i antenës duke përcaktuar me saktësi këndin e rënies për mbulim optimal

Hapi i gjashtë (35-40 minuta): Vlerësimi dhe reflektimi (diskutim/listë kontrolli)

- Diskutohet në grup, adresohen pyetjet e nxënësve dhe kryhet vlerësimi përfundimtar.

Instrumenta vlerësimi:

Listë kontrolli me kriteret e vlerësimit:

- A e analizoi vendndodhjen e klientit në lidhje me pikën e transmetimit?
- A e instaloi AP në kullë?
- A e tokëzoi AP?
- A e instaloi burimin e ushqimit të AP?
- A e instaloi linjën e transmetimit të AP?
- A e tokëzoi linjën e transmetimit?
- A e realizoi lidhjen e AP me pjesën tjetër të rrjetit dhënës?
- A e analizoi brezin e frekuencave për të kontrolluar për interferenca të mundshme?
- A e përzgjodhi kanalin e transmetimit të antenës?
- A e pozicionoi antenën horizontalisht dhe vertikalisht në mënyrë që të arrihet mbulimi me sinjal i të gjithë klientëve?

Nxënësi vlerësohet për:

- kreativitetin e treguar.
- saktësinë në dhënien e përgjigjeve.
- korrektësinë në punën e pavarur.
- bashkëpunimin në grup.
- komunikim etik gjatë punës.
- përdorimin e mjeteve digjitale.
- punën e pavarur

Model 2 - Seancë mësimore teorike

Ora e 2^{-të}

Datë: ____12.2025

Klasa 10^{-të}

Kualifikimi profesional: Hoteleri - Turizëm, Niveli II i KSHK-së

Lënda: Ushqim dhe pije L-13-443-24

Tema: Konservat, llojet, treguesit cilësorë, defektet, ruajtja.

Çështja: Rëndësia e konservimit të peshkut. Metodat e konservimit.

Kohëzgjatja: 1 orë mësimore


Objektivat e çështjes:

Në fund të çështjes nxënësi duhet:

- Të shpjegojë rëndësinë e konservimit të peshkut në funksion të sigurisë ushqimore dhe qëndrueshmërisë.
- Të klasifikojë saktë metodat e konservimit të peshkut.
- Të krahasojë metoda të ndryshme të konservimit të peshkut, duke dalluar tiparet dhe përdorimin e tyre praktik në gastronomi.

Faza	Kohëzgj/ Min	Aftësitë e buta	Metodat mësimore	Material/ Media	Vënia në zbatim
Hyrja (Parashtrimi)	5 min	Aktivizimi i nxënësve në diskutim.	Stuhi mendimesh	Tabelë e bardhë, markera, karta me ngjyra	Hapi i parë: Prezantimi i çështjes mësimore dhe objektivave. Diskutim: <i>Me aq informacion sa ju keni, pse është i rëndësishëm konservimi i peshkut dhe çfarë pasojash do të kishte mungesa e tij në sigurinë ushqimore? (Shënoni jo më shumë se një përgjigjeb në një pankartë)</i> Çdo nxënës shënon një ide në letër me ngjyrë dhe e vendos në tabelën e bardhë. Idetë grupohen dhe shërbejnë si urë lidhëse me njohuritë e reja.

Zhvillimi (Ndërtimi i njohurive)	25 min	Bashkëpunimi në grup, vendimmarrja, përgjegjësia profesionale, Saktësia dhe korrektësia	Diskutim Shpjegim Ilustrim me shembuj Punë në grupe të vogla Klaster	Flipçart/pinboard, markera, karta me ngjyra Smart Tv/tableta, materiale mësimore mbështetëse të përgatitura nga mësuesi dhe nga platforma mesovet, material në ppt. Platforma mesovet: https://mesovet.al/mod/hvp/view.php?id=6825 internet	Hapi i dytë: Dhënia e informacionit të ri. Nxënësit logohen në platformën mesovet.al dhe njihen me përmbajtjen digjitale mbi konservimin e peshkut. https://mesovet.al/mod/hvp/view.php?id=6825 <i>1. Rëndësia e konservimit të peshqve</i> Duke bërë edhe lidhjen me atë çfarë nxënësit thanë më parë, prezantohet informacioni i ri: Rëndësia e konservimit të peshqve: - Shëndeti i ekosistemit detar - Siguria ushqimore e njerëzve - Përfshin praktika të qëndrueshme të përpunimit dhe ruajtjes së peshkut për të mbajtur cilësinë dhe vlerën u shqimore të tij. <i>2. Metodatat kryesore të konservimit të peshqve.</i> Dhënia e njohurive të reja në lidhje me metodatat kryesore të konservimit të peshqve. Informacionet e reja integrohen edhe me diskutimet e nxënësve në lidhje me atë se çfarë ato dinë për secilën metodë. - Ftohja - Ngrirja - Mbingrirja (tejngrirja) - Tymosja - Marinimi - Tharja Secila nga metodatat shoqërohet edhe me shembuj real në formën e diskutimit të dhëna nga nxënësit në bazë të njohurive të marra më parë. <i>3. Punë në grupe të vogla:</i> Nxënësit ndahen në grupe të vogla me nga 3-4 nxënës. Çdo grup analizon një metodë konservimi dhe plotëson një tabelë orientuese (tipare, avantazhe, përdorim praktik në hoteleri). Çdo grup prezanton shkurtimisht përfundimet e veta, duke u mbështetur edhe në shembuj nga praktika profesionale.
---	---------------	--	---	--	---

					
Përfundimi (Perforcimi)	15 min	Shprehja e ideve dhe argumentimi i mendimit. Respektimi i mendimit të tjetrit - dëgjim aktiv. Demonstrim i etikës profesionale gjatë komunikimit dhe bashkëpunimit.	Punë në grupe dyshe, diagrame Venit, diskutim	Tabelë e bardhë ose flipçart, fletë pune me diagram Veni (të printuara), karta me ngjyra për plotësimin e diagramit, markera	Hapi i tretë: Detyrë në grupe dyshe Nxënësit punojnë në çifte për detyrën e dhënë. Secilit grup i caktohet të krahasojë dy metoda të konservimit të peshkut (p.sh. ftohja dhe ngrirja, ose tymosja dhe marinimi dhe kombinime të tjera). Gjatë punës, nxënësit identifikojnë dhe shënojnë në diagramin e Venit <i>elementet e përbashkëta</i> të metodave, si dhe <i>dallimet kryesore</i> që lidhen me mënyrën e ruajtjes, qëllimin, kushtet e temperaturës dhe përdorimin e tyre në kuzhina reale. Në përfundim, grupet prezantojnë shkurtimisht përfundimet e tyre, duke argumentuar zgjedhjet e bëra dhe duke reflektuar mbi rëndësinë e secilës metodë në garantimin e cilësisë dhe sigurisë ushqimore. Hapi i katërt: Vlerësim i nxënësve: Mësimdhënësi mban shënime në evidencën/fletoren regjistër rezultatet e detyrës për secilin nxënës si dhe aktivizimin e tyre në punët në grup dhe në diskutime. Mësimdhënësi jep vlerësime të përgjithshme për të gjithë nxënësit dhe në veçanti 2-3 nxënës duke përfshirë edhe angazhimin e tyre në orët e kaluara mësimore. Në vlerësimin e nxënësve përfshihen dhe aftësitë e buta si: etika e komunikimit, bashkëpunimi, përfshirja në diskutim. Në fund të orës mësimore bëhet vlerësimi i përmbushjes së objektivave dhe sqarim i koncepteve të paqarta. (feedback)

Detyrat e shtëpisë

A u arritën rezultatet e të nxënit sipas planifikimit?
Cilat metoda konservimi krijuan më shumë paqartësi te nxënësit?
Si mund të përmirësohet menaxhimi i kohës dhe përdorimi i teknologjisë në orët pasuese?